



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 5 qershor 2026

Lënda nr. 2025-02

Magbule Kelmendi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (në vijim: Paneli), i mbledhur më 5 qershor 2026, në përbërje të anëtarëve të mëposhtëm:

Znj. Marina MANCINI, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit
Z. Petko PETKOV, anëtar

i asistuar nga:
Znj. Pia HOLM, zyrtare ligjore

pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënies të EULEX-it në Kosovë, të datës 29 tetor 2009, për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregulloren e Punës së Panelit, të ndryshuar për herë të fundit më 2 qershor 2026,

pas shqyrtimit të çështjes, vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa është parashtruar përmes postës elektronike me datë 31 korrik 2025 dhe është regjistruar po në atë datë.
2. Me shkresën e datës 31 korrik 2025, Paneli e njoftoi Shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë (në vijim: Misioni) se ankesa ishte regjistruar.
3. Më 31 korrik 2025 dhe, sërish, më 18 shtator 2025, Paneli kërkoi nga parashtruesja e ankesës informacione shtesë lidhur me dokumentet e renditura në ankesë, të cilat nuk ishin bashkëngjitur.

4. Më 19 shtator 2025, parashtuesja e ankesës përmes postës elektronike dorëzoi dokumente shtesë.
5. Më 26 janar 2026, Paneli ia përcolli Shefit të Misionit parashtresën e pretendimeve, duke e ftuar Misionin t'i dorëzonte vërejtjet e tij jo më vonë se më 27 shkurt 2026.
6. Më 27 shkurt 2026, Shefi i Misionit dorëzoi vërejtjet e tij lidhur me lëndën.
7. Më 4 mars 2026, shkresa e Shefit të Misionit iu përcoll parashtresës së ankesës për informim.

II. FAKTET

8. Parashtuesja e ankesës u regjistrua në programin master prej 60 kreditesh ECTS në Menaxhment të Përgjithshëm Ndërkombëtar në Kolegjin Globus gjatë vitit akademik 2012/2013 dhe e fitoi titullin e masterit më 1 nëntor 2014.
9. Më pas, parashtuesja e ankesës aplikoi për studimet e doktoratës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Sarajevës dhe u regjistrua me kusht që diploma e saj e masterit të njihej. Më 4 shkurt 2019, ajo u njoftua se njohja e diplomës ishte refuzuar dhe se, për këtë arsye, nuk mund t'i vazhdonte studimet e doktoratës.
10. Arsyeja e refuzimit të njohjes së diplomës së masterit ishte mungesa e vulës apostille, e cila vërteton autenticitetin e saj. Më 19 janar 2022, zëvendësministri i Arsimit i Republikës së Kosovës e njoftoi parashtresën e ankesës se vula apostille nuk mund të lëshohej, pasi programi i masterit nuk kishte marrë akreditimin e nevojshëm.
11. Sipas parashtresës së ankesës, ekziston një grup i organizuar kriminal që kryen mashtrime duke lëshuar diploma të falsifikuara, përfshirë edhe diplomën e saj të masterit, si dhe duke përdorur korrupsionin dhe favorizimin nga zyrtarë të ndryshëm të institucioneve të Kosovës, përfshirë Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Ministrinë e Arsimit, me qëllim të mbulimit të veprimtarisë së tyre kriminale. Emrat e anëtarëve të këtij grupi, si dhe të zyrtarëve të përfshirë, janë përmendur në ankesë.
12. Parashtuesja e ankesës deklaroi se rasti është hetuar nga autoritetet prokuroriale të Kosovës dhe se, me kërkesën e saj, EULEX-i kishte vendosur ta monitoronte atë. Megjithatë, më pas rasti u mbyll nga një prokuror i ri, të cilit iu caktua lënda dhe për të cilin parashtuesja e ankesës beson se është një nga zyrtarët e lartpërmendur. Pas vendimit të prokurorit, parashtuesja e ankesës u njoftua se EULEX-i kishte ndërprerë monitorimin e rastit.

III. ANKESA

13. Parashtuesja e ankesës pretendon se, për shkak të mosnjohjes së diplomës së saj të masterit, për të cilën u konstatua se ishte lëshuar nga një institucion (Kolegji Globus) i paautorizuar për të ofruar programe të masterit prej 60 kreditesh ECTS, ajo humbi mundësinë për të vazhduar studimet e doktoratës

jashtë vendit dhe për t'u punësuar si ligjëruese universitare. Si pasojë e kësaj, ajo pretendon se ka pësuar dëm material dhe emocional.

14. Parashtruesja e ankesës pretendon se veprimet e personave të përmendur në paragrafin 13, përfshirë prokurorin që e mbylli rastin, kanë shkelur të drejtat e saj të njeriut, në veçanti të drejtën për arsim të lartë (neni 26(1) i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut), të drejtën për gjykim të drejtë (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) dhe të drejtën për mjet juridik efektiv (neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).
15. Parashtruesja e ankesës ankohet se EULEX-i e ndërpreu monitorimin e rastit pasi prokurori vendosi ta mbyllte atë, pa u takuar asnjëherë me të.
16. Parashtruesja e ankesës shpreh dyshimin se “edhe brenda EULEX-it mund të ketë persona që posedojnë diploma të tilla, gjë që mund të ketë kontribuar në heshtjen e qëllimshme të hetimeve”, duke iu referuar diplomave të lëshuara nga Kolegji Globus, përfshirë edhe diplomën e saj.
17. Parashtruesja e ankesës kërkon krijimin e një task force të posaçme për të mbikëqyrur punën e prokurorëve dhe zyrtarëve policorë të Kosovës të përfshirë në veprimtari kriminale, si dhe për të kërkuar llogaridhënie nga ta.

IV. PARASHTRESA E MISIONIT

18. Në parashtresat e tij, Shefi i Misionit thekson se kompetenca e Panelit për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga EULEX Kosova nuk përfshin të gjitha detyrat e Misionit, por kufizohet vetëm në detyrat e tij ekzekutive, siç parashikohet qartë në Rregulloren e Punës. Ai thekson më tej se nga nenet 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/PESC (i ndryshuar dhe plotësuar) rezulton qartë se detyrat e monitorimit, mentorimit dhe këshillimit janë të ndara nga detyrat ekzekutive.
19. Në dritën e sa më sipër, Shefi i Misionit konsideron se ankesa duhet të shpallet e papranueshme, pasi nuk ka të bëjë me ushtrimin e detyrave ekzekutive të Misionit.

V. VLERËSIMI I PANELIT

20. Sa i përket të drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç parashikohet në Konceptin e Llogaridhënies së EULEX-it në Kosovë të 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Panelit janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), të cilët përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
21. Para se të shqyrtojë ankesën në themel, Paneli duhet të përcaktojë nëse ankesa është e pranueshme, duke marrë parasysh Rregullin 29(1) të Rregullores së Procedurës. Kjo dispozitë parashikon se Paneli mund ta shpallë një ankesë të

papranueshme në procedurë të përshpejtuar, ndër të tjera, nëse ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit.

22. Në përputhje me rregullin 25(1) të Rregullores së Punës, juridiksioni i Panelit është i kufizuar në ankesat që kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i Misionit përcaktohet në nenin 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të BE-së 2008/124/CFSP, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Këshillit të BE-së (CFSP) 2018/856.
23. Paneli vëren se objekt i ankesës është ndërprerja nga ana e Misionit e monitorimit të rastit që ka të bëjë me parashtruesen e ankesës, pa u takuar paraprakisht me të.
24. Paneli vëren gjithashtu se detyra e Misionit për monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të përzgjedhura në institucionet e drejtësisë penale dhe civile të Kosovës nuk bën pjesë në mandatin ekzekutiv të Misionit (shih lëndën 2019-02, *Driton Hajdari dhe Teuta Bici-Hajdari kundër EULEX-it*, 7 korrik 2022, paragrafi 46).
25. Parashtruesja e ankesës nuk e ka treguar bazën mbi të cilën pretendon se monitorimi i rastit mund të konsiderohet pjesë e mandatit ekzekutiv të Misionit, dhe as nuk ka paraqitur prova për ndonjë veprim ose mosveprim me faj që mund t'i atribuohet EULEX-it.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri, konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar ankesën, pasi ajo bie jashtë juridiksionit të tij në kuptim të Rregullave 25(1) dhe 29(1)(d) të Rregullores së Procedurës, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Marina MANCINI
Ushtruese e Detyrës së Kryesueses

Petko PETKOV
Anëtar